



REPUBLIKA KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

KONTRATË

Numri i kontratës: 633-22-8934-5-2-1/C605

KOMUNA E ISTOGUT, Njësia e Prokurimit, të cilën e përfaqëson z. Gëzim Ademaj, zyrtar përgjrgjës i prokurimit, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

"Infra-Plus" SH.P.K., Rr.Luan Haradinaj Sol.1 H.1, Prishtinë, me NRB 810175225 të cilën e përfaqëson z. Musa Islamaj (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

NDERTIMI I RRUGES FUSHORE DHE KANALIT TE UJITJES NE MUZHEVINË
me numër identifikues: 633-22-8934-5-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:
NDERTIMI I RRUGES FUSHORE DHE KANALIT TE UJITJES NE MUZHEVINË

Nr. I prokurimit	633-22-8934-5-2-1/C605
I Brendshëm	633-22-062-5-2-1/C605

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: 33 981,79 €; *[fjalë]*

Tridhjetetremijëenëntëçindetëdhjetenjë-79/100Euro.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);

Plani për menaxhimin e kontratës

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4

4.1 Të gjitha punimet rreth aktivitetit të prokurimit në fjalë do të fillojnë pas nënshkrimit të kontratës dhe përfundimit të punës për menaxhim të kontratës dhe do të përfundojnë brenda 2 muaj apo 60 ditë kalendarike, por jo më larg se **01.12.2022**

Neni 5 Komunikimet


5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën SHQIPE në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Gëzim Ademaj
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	03.10.2022
Vula:	

Për Kontraktuesin

Emri:	Musa Islamaj
Pozita:	Drejtör,
Nënshkrimi: Fer	
Data:	03.10.2022
Vula:	

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatën e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET

Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara në shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët të cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkritazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdojë vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranim të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimi përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimi do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimi nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimi dhe të cilat kanë mbetur të përcaktuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimi. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 633-22-8934-5-2-1/C605

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë GJUHA SHQIPE
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës, me vlefshmëri 30 ditë me gjatë se perfundimi i kontratës.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: Sigurimi i vend punishte do të jete përgjegjësi e Operatorit Ekonomik dhe të gjitha dëmtimet e punëve, dëmtimet e pronës apo humbjet e materialeve dhe pajisjeve në vend punishte janë në përgjegjësi të Operatorit ekonomik deri në shumën e dëmtimeve apo humbjeve, sigurimi i vend punishte do të jetë + 30 dite nga plani dinamik i ofruar pra nëse zgjasin punimet zgjatet edhe sigurimi i vend punishte pra + 30 dite.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të caktohet në <i>planin e menaxhimit-Pas nënshkrimit të kontratës.</i>
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 2 MUAJ, pas datës së nënshkrimit të planit të menaxhimit të kontratës
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha punët janë 0.25% për çdo ditë vonese, por jo më shumë se 10% e vlerës së kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Ditari i Punës dhe Libri ndërtimor
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxher i Kontratës është Kompanija mbikqyrese “PMN” SHPK NPN & “UNIVERS-MI” nga Prishtina e cila do ta bëjë mbikqyrjen dhe realizimin e projektit deri në përfundimin e tij, si dhe do të punojnë planin për menaxhimin e kontratës, bazuar në kontratën e AK-Nr. 633/22/6174/221 datë 28.07.2022
Pagesat	24	Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate. Pagesat do të behen pas situacioneve për punët të përfunduara, ndërsa pagesa përfundimtare behet pas pranimit të gjitha punimeve pa vërejtje.
Shkaqet kompensim për	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 3 ditë pas nënshkrimit të kontratës.

Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Palët do të provojnë në mënyrë miqësore të zgjidhin marrëveshjet ku do të organizojnë së paku (2) dy takime për zgjidhje miqësore e nëse këto takime nuk kanë sukses, atëherë kompetente do të jetë gjykata.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për çështje ekonomike

PROJEKTI: TRASIMI I RRUGËS RURALE DHE KANALIT TË UJITJES NË MUZHEVINË "Ndertimi i Rugës Fushore dhe Kanalit për ujtitje në Fshatin Muzhevinë" PARAMASA DHE PARALLOGARIJA: AKSI 1+ AKSI 2+ AKSI 3: L=615.00+385.00+245.00= 1,245.00 M (A) PARAMASA DHE PARALLOGARIJA: AKSI 1 ; L=615.00 M.					
Nr.	Pershkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi €	Vlera
1	Punët Pergaditore				
1.1	Pastrimi i trases në pjesën që do të ndërtohet kanali dhe rruga me gjërësi b=8.00m'. Pastrimi dhe bartja e rrenjeve deri në deponin ma te afert e caktuar nga organi mbikqyrës (rrenjë dhe shkurrel e imëla janë mbetje të lëna nga kontraktori i kaluar). Dheu i mihur te shfrytëzohet për mbushje dhe nivelizim rreth kanalit. Llogaria për m' të trasës së shënuar.	m'	615.00	1.00	615.00
1.2	Punimet gjeodezike ku parashihen keto punime: Inqizimet e trases para fillimit te punimeve me të gjitha parametrat e duhura . Fiksimi i pikave gjeodezike ne teren sipas projektit bazuar edhe ne kushtet e terenit. Percjellja e duhur e punimeve gjatë ekzekutimit. Llogaria për m' të trasës së shënuar.	m'	615.00	1.00	615.00
				Gjithsej: 1.	1,230.00
2	Punimet tokësore	Njësia	Sasia	Çmimi €	Vlera
2.1	Germimi i kombinuar i dheut të kat. III dhe IV për Kanal dhe rrugë me eskavator dhe dorë me gjerësi dhe thellësi sipas prerjes terthore për kanal dhe per rrugë. Materiali i mihur te perdoret për mbushje në trupin e rrugës dhe rreth Kanalit. Planifikimi i fundit të kanalit me dorë me saktësi +/- 5 cm. si dhe ngjeshja e bazës së fundit të kanalit, nën bazës së Rugës me cilindër. Msh≥30MN/m2. Trasea duhet ne tersi t'i pergjigjet kushteve nga projekti.	m³	312.00	2.50	780.00
2.2	Furnizimi, blerja dhe transporti i materialit guror CBR>5%. Punimi i mbushjes me shtrirje dhe ngjeshje në shtresa për trupin e rrugës . Ngjeshja te behet me cilindër, Msh≥60 MN/m2, Gjersija sipas profilitt karakteristik (Projektit). Trasea duhet ne tersi t'i pergjigjet kushteve nga projekti.	m³	1,189.93	3.00	3,569.79
2.3	Furnizimi, blerja dhe transporti i materialit , punimi i shtresës së tamponit nga guri gëlqeror , fraksion 0-63mm me trashësi t=20cm në gjendje të ngjeshur Msh≥80MN/m2 .Trasea duhet ne tersi t'i pergjigjet kushteve nga projekti.	m³	734.00	8.00	5,872.00
2.4	Furnizimi, blerja dhe transporti i zhavorit (0-31) mm .Nivelizimi i fundit të Kanalit +/- 5 cm. me trashësi mesatare d = 10 cm nën pllaken e poshtme të kanalit me nivelizim të duhur ne tërë gjatësin e Kanalit. Ngjeshja me me vibro zhabë pllakore.	m³	62.00	10.00	620.00
				Gjithsej: 2.	10,841.79



3.	NDERTIMI I KANALIT KATROR a=50 cm,b=60 cm.t=15 cm.	Njësia	Sasia	Çmimi €	Vlera
	Ndertimi i kanalit për ujitje, betonarme klasa c-30/37				
3.1	Furnizimi, blerja e betonit në fabriken e betonit,transporti deri në punishte me perzierse betoni (Mikser). Betonit ti shtohen aditivet joupëpërshkuese.Punimi ,vendosja dhe kompaktimi i betonit te klasit C-30/37 per betonimin e pllakes dhe mureve anesore te kanalit.Gjatë betonimit betoni te ngjeshet me vibrator.Armimi të behet me armatur rrjetë Ø10 mm. hapi 15*15 cm. lakimi dhe vendosja e armaturës në pllaken dhe muret e kanalit. Ne llogari të perfishihet pergaditja e pahive, vendosja e betonit në veper, demontimi i pahive , pastrimi i kanalit nga mbeljet e betonit si dhe keputja e distancerave metalik. Paraprakisht ti prezentohen organit mbikqyrës alestet paraprake të betonit. Gjatë betonimit të mirren mostrat për shqyrtim.Kanali me dimensione sipas projektit. Llogarija për m³.të Betonit.	m³	185.00	100.00	18,500.00
3.2	Furnizimi,blerja dhe transportimi i betonit për ndertimin e pllakave të urave për kyqje në prona.Gjersija L = 5m, t= 12 cm. gjithsejt (Copa 5, pozicione) me pahi të duhur mbi kanalit e ujitjes me beton C-30/37 .Armimi me armatur Ø 12 mm, ne dy zonat,hapi 12*12 cm.Furnizimin ,transportin,prerja,lakimin dhe vendosjen e armatures se brinjezuar.S-400/500 Ø12mm .Llogarija për m³.	m³	3.00	100.00	300.00
3.3	Furnizimi,transporti dhe vendosja e portave metalike për kontrollimin e sasis së ujit me dim sipas projektit. Ne llogari të kalkulohet furnizimi i materialit dhe punimi i portës metalike komplet me mekanizëm për levizen e Portës si dhe mekanizmin për montim. Llogarija për copë.	Copë	6.00	200.00	1,200.00
3.4	Punimi i lëshesave gypore , Furnizim,blerja transporti dhe montimi i gypave të armuar nga betoni C-20/25 të vendosur në shtresë tamponi.Punimi i kokave të lëshesave me C-30/37 . Gypa Ø400mm. Ne një pozicion sipas projektit.Llogarija për copë.	Copë	10.00	20.00	200.00
3.5	Hapja dhe formsimi i kanalit ansor të rrugës si dhe humuslmi i bankinës. Hapja e kanalit me eskavator.Llogarija për m'.Pastrimi i punishtës,largimi i te gjitha mbetjeve pas përfundimit të punimeve.Te gjitha elementet e atakuara gjatë punimeve (gardhi me tela gjembor,Shkelja e arave me makineri,damtimi i vijave kulluese,damtimi i te mbjellave) të gjitha të kthehen në gjendjen paraprake.	m'	500.00	0.90	450.00
			Gjithsej: 3.		20,650.00
Punët Pergaditore: Aks1					1,230.00
Punimet Tokësore : Aks1					10,841.79
Kanali i ujitjes : Aks1					20,650.00
TOTALI ME TVSH. AKSI 1.					32,721.79



(B) PARAMASA DHE PARALLOGARIJA: AKSI 2 ; L=385.00 M.					
Nr.	Pershkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	Punët Përgaditore				
1.1	Prerja e shkurreve dhe e drunjëve me shkulje të rrënjëve në pjesen ku do te ndertohet Kanali dhe Rruga, gjersija b=8.00 m. Pastrim dhe bartje të materialit deri në deponin ma te afert e caktuar nga organi mbikqyrës. (deri në deponi do të barten velem rrënjët dhe shkurret e imta, drujt do ti marrin qytetarët).Dheu i mihur te shfrytëzohet për mbushje dhe nivelizim rreth kanalit. Llogaria për m' të trasës së shënuar.	m'	385.00	1.00	385.00
1.2	Punimet gjeodezike ku parashihen keto punime: Inqizimet e trases para fillimit te punimeve me të gjitha parametrat e duhura . Fiksimi i pikave gjeodezike ne teren sipas projektit bazuar edhe ne kushtet e terenit. Percjellja e duhur e punimeve gjatë ekzekutimit. Llogaria për m' të trasës së shënuar.	m'	385.00	1.00	385.00
			Gjithsej: 1.		770.00



(C) PARAMASA DHE PARALLOGARIJA: AKSI 3 ; L=245.00 M.					
Nr.	Pershkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi €	Vlera
1	Punët Pergaditore				
1.1	Prerja e shkurreve dhe e drunjëve me shkulje të rrënjëve në pjesen ku do te ndertohet Kanali dhe Rruga, gjersija b=8.00 m. Pastrim dhe bartje të materialit deri në deponin ma te afert e caktuar nga organi mbikqyrës. (deri në deponi do të barten vetem rrënjët dhe shkurret e imta, drujt do ti marrin qytetarët).Dheu i mihur te shfrytëzohet për mbushje dhe nivelizim rreth kanalit. Llogaria për m' të trasës së shënuar.	m'	245.00	1.00	245.00
1.2	Punimet gjeodezike ku parashihen keto punime: Inqizimet e trases para fillimit te punimeve me të gjitha parametrat e duhura . Fiksimi i pikave gjeodezike ne teren sipas projektit bazuar edhe ne kushtet e terrenit. Percjellja e duhur e punimeve gjatë ekzekutimit. Llogaria për m' të trasës së shënuar.	m'	245.00	1.00	245.00
			Gjithsej: 1.		490.00
TOTALI ME TË GJITHA NGARKESAT					33,981.79

